



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT "IHSAN ÇABEJ" LUSHNJE

Nr ____prot

Lushnje ____/____/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparim dhe Mirembajtje CT Skaner Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore - 50421000-2

Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve me rreze x - 50421200-4

REF 78563-08-29-2023

**VLERA E FONDIT LIMIT/ Vlera e pritshme e kontrates:Fondi limit-5 100 480leke pa tvsh
Marreveshje kuader** parashikuar për 12 muaj nga momenti i nënshkrimit te kontratës

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e spitalit lushnje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) *Formulari i ofertes ekonomike, sipas shtojces 1.*
- b) *Formulari i sigurimit te ofertes, sipas shtojces 3.*
- c) *Formulari permbledhes i vetedeklarimit, sipas shtojces 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare(2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuesit duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuesit të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuesit argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuesit për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuar të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëria audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.2.3Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij ,(Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik lëshuar nga QKB).(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses te nje ose disa kontratave per shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontratën e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "PerProkurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entetkontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose entikontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ne te cilen eshte epercaktuar se: "*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: ... Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*". Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa emësimi është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe ne piken 4 te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave teProkurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fonditlimit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten 1 Inxhinier të diplomuar në një nga profilet Biomjeksor/Elektronike/Elektrike/Mekatronike/ Mekanik/IT ose dege te tjera te ngjashme me to, dhe te jene te jene trajnuar per aparatura mjekësore.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër:

- CV-në e specialistit/ve;
- Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/çertifikuara për dhënien e tyre,
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
Listëpagesa ku të figurojnë emrat e inxhinierëve të deklaruar për periudhën **Korrik 2023**

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

Shenim:

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.***

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e pajisjeve që do të mirembaje ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi për Shqipërinë, për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, për objektin e prokurimit
Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer ose fotokopje e noterizuar.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 (*aftësia teknike*) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 2 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998

datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikaten ISO 9001:2015 (ose ekuivalent) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 (ose ekuivalent) mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, (ose të perditesuara) në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike dhe me pikën 3 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.3.5 OE duhet të paraqesë Autodeklarate që merr përsipër furnizimi/zevendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesorë dhe se:

Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të çertifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitetet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.

Të jenë të certifikuara me CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara në tregun Europian.

Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesorët duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.

Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

(Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kësaj kontrate. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit.)

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Në mbështetje të Nenit 17 të Ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjekësore” si dhe të nenit 7 të ligjit 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014”, krahas kërkesës së miratimit/certifikimit CE, AK lejon edhe mundësinë e paraqitjes së certifikatës FDA, si një dokument, i cili konfirmon konformitetin e pajisjeve/artikujve mjekësorë objekt prokurimi, me

qëllim hartimin e kriterit në konformitet me dispozitat në fuqi, si dhe moskufizimin e OE, të cilët tregtojnë dhe paraqesin pajisje dhe artikuj mjekësore vetëm me certifikimin FDA dhe jo me certifikimin CE.

2.3.6 OE duhet të paraqesë Autodeklarate ku garanton se në rast të shpalljes fitues, do të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me pajisjen, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.7 Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambientet e Spitalit Lushnje, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj

Argumentimi: Kriteret e vendosura në DST në pikat 6, 7 dhe 8 janë vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr.145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”. Deklarata egarancise për shërbimin e mirëmbajtjes riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjesët mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me pajisjen, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi,

2.3.9 OE duhet të paraqesë Autodeklarate me anë të së cilës të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafit (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të vërtetuar që operatori vepron sipas legjisllacionit në fuqi bazuar në nenin 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar.

2.3.12. Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjet do të jetë - Mirëmbajtje parandaluese dhe korigjuese)ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korigjuese për të gjithë difektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajtje parandaluese dhe korigjueseduhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjeve, vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisje të prodhuesit Philips (ose ekuivalente)

Pajisja/Sistemi : CT Skaner

Modeli :Mx 16

Prodhuesi :PHILIPS HELATHCARE

Operatori Ekonomik fitues duhet të permbush shërbimet :

- 1.Sherbimet e mirembajtjes parandaluese I cili do te kryhet 1(nje) here ne muaji
- 2.Sherbimet e mirmbajtjes korigjuese qe konsiston ne percaktimin e pranise se nje defekti ose ne mos funksioni,ne identifikimin e shkaqeve etj.
- 3.Sherbimet e kalibrimitdhe paisjet e nevojshme per kryrjen e tij sipas rekomandimeve te prodhuesit
- 4.Sherbimet e testimiit periodic te sigurise elektrike dhe mekanikene perputhje me udhezimet teknike evropiane dhe nderhyrjet e nevojshme e individuale sipas paisjes per te siguruar konformitet me rregulloret perkatese.
- 5.Zevendesimin e pjeseve perberese te sistemit ,te kembimit ,perdorimit dhe konsumitsi me poshte :

-Tubi I rrezeve X (blerjadheinstalimi I saj ne rast demtimi)per paisjet perkatese .

-Gjeneratori

-te gjitha pjeset e tjera te kembimit ,per funksionimin sipas standarteve

-Blerja dhe furnizimi me helium per rezonancat magnetike

-Paisja UPS I paisjeve (Skaner ,resonance dhe angiografi)si dhe te gjitha pjeset e tjera te kembimit qe mund te lind nevoja te zevendesohen kur difektohen me qellim mire funksionimin e paisjes

6.Operatori ekonomik fitues duhet te parashikojë blerjet dhe zevendesimin e te gjitha pjeseve

Dhe materialeve te kembimit gjate kryerjes se sherbimeve me shpenzimet e tij .Garancia e pjeseve te kembimit do te jete 1(nje) vit .

1. Pajisje CT Skaner model MX 16 Slice (ose ekuivalente)

Shërbimet që duhet të ofrohen:

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisjur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjet përkatëse.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së

vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.

Të gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rrezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjet përkatëse
- Gjeneratori
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Blerja dhe furnizimi me helium (për rezonancat magnetike)
- Pajisja UPS i pajisjeve
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur difektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.
- Chiller tek MR

I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimin.

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, i

Kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Kjo mund të aplikohet në rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve apo shtimit të pajisjeve të reja për shkak të përfundimit të periudhës së garancisë. Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës. Vlera e zvogëluar ose shtuar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisjeje.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve:

Personeli teknik i të Kontraktuarit do të garantojë mbulimin e shërbimit për 52 javë në vit, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia dhe shpeshtësia e ndërhyrjeve.

I Kontraktuari duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I Kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda ditës së punës për pajisjet objekt kontrate.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe jo me shume se 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke

përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzimi i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

Specifikimet teknike janë vendosur në baze të materialit të përgatitjes së specifikimeve teknike të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdher të brendshëm si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njësia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si më poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :
11.09.2023 ora 10.00